



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 45, datë 20 .11. 2012

PËR

**“EMËRTIMIN E SHESHIT “SHQIPONJA“ DHE VENDOSJEN E MONUMENTIT
“SHQIPONJA“, NË KUADRIN E FESTIMEVE TË 100 VJETORIT TË PAVARËSISË”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për emërtimin e sheshit “Shqiponja” dhe vendosjen në kuadrin e festimeve të 100 Vjetorit të Pavarësisë të monumentit “Shqiponja”, në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII gërma “a” dhe nenit 32, gërma “II” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I

1. Të miratojë emërtimin e sheshit “Shqiponja” dhe vendosjen në kuadrin e festimeve të 100 Vjetorit të Pavarësisë, të monumentit “Shqiponja” në rrethrotullimin midis rrugës “Teodor Keko” dhe rrugës “Dritan Hoxha”, sipas projektit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI